



**Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“TEKNOLOGJI KIMIKE”

Niveli IV në KSHK¹, referuar niveli IV të KEK²

Q-IV-16

Tiranë, Prill 2016

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Teknologji Kimike”			Kodi Q-IV-16
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Teknologji Kimike”, niveli IV në KSHK , referuar niveli IV të KEK, është të përgatisë specialistë të nivelit teknik/menaxher në fushën e teknologjisë kimike për t’u punësuar në veprimtaritë e menaxhimit të një reparti, sektori, linje prodhimi, brigade ose njësie të ngjashme të kësaj fushe apo për krijimin dhe menaxhimin e një biznesi privat, person fizik ose juridik.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrojnë arsim profesional në drejtimin mësimor “Teknologji Kimike”, niveli IV në KSHK , referuar niveli IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet e nivelit III në KSHK, referuar niveli III të KEK, drejtimin mësimor “Teknologji Kimike”; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Teknologji Kimike”, niveli i IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli që përkon me nivelin profesional teknik/menaxher në këtë fushë, të njohur në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje/kompani të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitetet në drejtimin “Teknologji kimike”.</p> <p>Gjithashtu, individ mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e teknologjisë kimike, në profesionet teknolog/teknik për përpunimin dhe prodhimin e naftës dhe nënprodukteve të saj, prodhimin e materialeve të ndërtimit si; materialet lidhëse (gëlqere, çimento, gips), qeramikës, bojërave, betoneve, asfalto betonet, tullave të lehtësuara silikate, si dhe të përgatitjes së kollës, finos dhe stukos, të përpunimit të letrës dhe gomës, etj.</p> <p>Të krijojë dhe drejtojë sipërmarrje private në sektorin e ruajtjes, kontrollit të cilësisë, të ambalazhimit, transportimit dhe tregtimit të tyre etj.</p> <p>Po ashtu, në varësi të kualifikimit të përfutur në nivelin e III-të, ai/ajo mund të punësohet në një biznes që operon në fushën e ndërtim-montimit, në sektorët e remontit e të mirëmbajtjes, në linjat teknologjike të përpunimit të naftës dhe nënprodukteve të saj, të prodhimit të materialeve të ndërtimit, të përpunimit të letrës etj.</p> <p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Teknologji Kimike”, niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK i jep mundësi individit të fitoj të drejtën e Diplomës së Maturës Shtetërore Profesionale. Me përfundimin e këtij niveli, individ ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.</p>			
Data e validimit	<i>(kur të miratohet)</i>			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	Nuk ka			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Në përfundim të këtij kualifikimi profesional në Nivelin IV të KSHK, referuar niveli IV të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë e mëposhtme:

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të vleftësojë mendime mbi çështje etike që lidhen me veprimtari të ndryshme ekonomike;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet ne komunitet;
- Të shpjegojë konceptet financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare..);
- Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të ekzaminojë teknika mbështetëse për të menaxhuar dhe zbatuar një projekt në situata të ndryshme (analiza SWOT dhe diagrama e GANTIT);
- Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
- Të përshkruajë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale dhe globale;
- Të analizojë interesat, zotësitë dhe aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme përfshirë vetëvlerësimin.
- Të shpjegojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit), duke u përqendruar në mënyrën e drejtimit, integritimit, motivimit dhe mbikëqyrjes së tyre;
- Të listojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
- Të shpjegojë dobinë e marketingut në biznes;
- Të listojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në fushën e biznesit përkatës, si pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së tij;

Kostot

- Të përshkruajë elementët e përgjithshme të përcaktimit të kostos;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së kostos së transportit jashtë të prodhimeve, sipas llojit e sasisë së lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse, etj.;
- Të përshkruajë konceptin e normimit e punës në përgjithësi, kohët kryesore dhe ndihmëse të punës në makineri, pajisje, linja dhe procese teknologjike;

- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të çmimit të produktit dhe/apo shërbimit të një veprimtarie të caktuar;
- Të interpretojë çmimet e lëndëve të para, të lëndëve dhe materialeve ndihmëse, si dhe të shërbimeve që përdoren në njësitë e prodhimeve dhe ato ndihmëse të veprimtarisë profesionale, sipas veçorisë së tyre për mënyrën e furnizimit, përgatitjen dhe përpunimin e tyre, transportimin, magazinimin, ruajtjen, kontrollin e cilësisë, ambalazhimin, marketingun dhe tregtimin e produktit të gatshëm etj.);

Organizimi i punës

- Të shpjegojë mënyrën e organizimit të punës për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, mbrojtjes nga zjarri/gazi, si dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit të punës për drejtimin e njërive të prodhimeve dhe shërbimeve të aktivitetit në drejtimin e teknologjisë kimike, si: ndërmarrje/kompani, kombine, uzina përpunimi, fabrika, reparte prodhimi dhe shërbimi, linja/implante prodhimi, sektorë, brigadë, turne, grupe etj.;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të urdhrave të punës, të skemave dhe kartave teknologjike të thjeshta të prodhimit/shërbimit të aktivitetit në drejtimin e teknologjisë kimike;
- Të përshkruajë mënyrën e kontrollit cilësor dhe teknik operacional, gjatë proceseve të prodhimit, magazinimit/depozitimit, ruajtjes deri në tregtimin e produktit të gatshëm, etj.;
- Të përshkruajë organizimin e procesit të prodhimit/shërbimit, sipas posteve dhe stadeve të punës/shërbimeve, deri në tregtimin e produktit të gatshëm, etj.;
- Të shpjegojë përcaktimin e rezervës së nevojshme materiale (lëndë të para, ndihmëse dhe produkte të gatshme etj.), për të mos penguar procesin në njësitë e prodhimit/shërbimit dhe në furnizimin e tregut;
- Të shpjegojë procedurën e transportit në përgjithësi, mjetet që përdoren, dokumentet kryesore të furnizimit apo shpërndarjes së lëndëve të para, ndihmëse, si dhe të produkteve të gatshme, etj.;
- Të përshkruajë transportin e brendshëm dhe të jashtëm të lëndëve të para, ndihmëse, si dhe të produkteve të gatshme, linjat teknologjike, mjetet dhe pajisjet që përdoren për lëvizjen dhe transportimin në proceset teknologjike kimike të naftës dhe materialeve të ndërtimit deri në një fundore të tregtimit dhe përdorimit të prodhimit të gatshëm

Legjislacioni i punës dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të punës, me theks të veçantë në të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë, që përfshin aspektet teknike/teknologjike, shkallët e përgjegjësisë, dokumentacionin e detyrueshëm, afatet e instruktimit të punonjësve, si dhe të kontrollit periodik dhe të trajtimit shëndetësor, etj.;

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të mbrojtjes së mjedisit në punë, që përfshinë aspektet teknike/teknologjike, lejet e punës, shkallët e përgjegjësisë, dokumentacionin e detyrueshëm, raportimet periodike, etj.;
- Të përshkruajë dokumentacionin e “vlerësimit të riskut” në teknologjinë kimike;
- Të shpjegojë veçoritë e dokumentacionit të shkruar dhe miratuar për çdo vend pune, të sigurimit teknik, mbrojtjes ndaj gazit dhe zjarrit në teknologjinë kimike;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga; shkarkimet e gazrave të dëmshëm në ajër, shkarkimet e lëngjeve e të ujërave të ndotur (infektuar), të mbetjeve të ngurta në mjedis, etj.;
- Të shpjegojë detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve në lidhje me sigurinë vetjake, sigurinë e vendit të punës, sigurinë e mjedisit, mjeteve mbrojtëse si dhe pajisjeve, makinerive, linjave dhe aparaturave të punës në teknologjinë kimike;
- Të përshkruajë masat që duhen marrë dhe pajisjet e nevojshme për të bërë neutralizimin e efekteve të dëmshme të gazrave, të ujërave të ndotur dhe të mbetjeve të ngurta që gjenerojnë proceset dhe shërbimet e teknologjisë kimike në mjedis;
- Të përshkruajë veprimet e nevojshme që duhen kryer për të dhënë ndihmën e shpejtë në raste aksidentesh dhe avarish në sektorë të ndryshëm të teknologjisë kimike;
- Të përshkruajë përdorimin e mjeteve mbrojtëse dhe aparaturave të sigurisë dhe shpëtimit në rast aksidenti në punë;
- Të përshkruajë masat që duhen marrë dhe pajisjet e nevojshme për të bërë parandalimin dhe luftimin e zjarreve që mund të ndodhin në proceset dhe shërbimet e teknologjisë kimike;
- Të përshkruajë veprimet e nevojshme që duhen kryer për të dhënë ndihmën e shpejtë në raste aksidentesh dhe avarish që shoqërohen me zjarre, eksplozione dhe toksifikime në proceset dhe shërbimet e teknologjisë kimike;
- Të përshkruajë përdorimin e mjeteve mbrojtëse dhe aparaturave të sigurisë dhe shpëtimit në rast aksidenti në punë;
- Të shpjegojë masat që duhet të merren dhe standardet e higjienës vetjake dhe kolektive të vendit të punës dhe ambienteve të prodhimit/shërbimit/tregtimit në teknologjinë kimike;
- Të shpjegojë masat kryesore për minimizimin dhe reduktimin e mbetjeve në mjedis nga proceset dhe shërbimet e teknologjisë kimike;
- Të përshkruajë mënyrat e grumbullimit, ambalazhimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta, gazta dhe të lëngta që dalin nga procese dhe shërbime të teknologjisë kimike;
- Të përshkruajë masat për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar nga proceset e teknologjisë kimike;

Infrastruktura e ndërmarrjes/kompanisë të “Teknologjisë Kimike” dhe rrjetet inxhinierike

- Të përshkruajë plan-vendosjet e kombineve, uzinave të përpunimit, fabrikave, reparteve/linjave/impianeteve dhe njërive të prodhimeve/shërbimeve të teknologjisë

kimike, skemat e furnizimit të energjisë, të ujit, të telekomunikacionit, të avullit të ujit, të ajrit, gazit inert, të shkarkimeve të ujërave, mbetjeve të ngurta dhe të gazrave industrial/shërbimit,.... etj.;

- Të shpjegojë karakteristikat tekniko-ekonomike të makinerive, pajisjeve, aparaturave, armaturave/tubacioneve, të impianteve në linjën apo njësinë e prodhimit/shërbimit të teknologjisë kimike, duke pasur parasysh parimin e veprimit, prodhimtarinë ose kapacitetin, fuqinë, shpejtësinë, përmasat, sistemin e komandimit e të sigurisë në punë të tyre, etj.;
- Të interpretojë skemat e sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, gazi dhe pluhurat, si dhe skemat e sistemit të sinjalizimit dhe evakuimit në raste aksidentesh dhe avarish në sektorë të ndryshëm të teknologjisë kimike, etj.;
- Të përshkruajë sistemet dhe mjetet e shpëtimit dhe të dhënies së ndihmës së shpejtë në raste aksidentesh dhe avarish në sektorët e prodhimit/shërbimit të teknologjisë kimike, etj.;
- Të përshkruajë sistemet dhe pajisjet e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e zjarreve/eksplozioneve që mund të ndodhin në proceset dhe shërbimet e teknologjisë kimike, etj.;

Standardet teknike/teknologjike, dokumentacioni dhe TIK

- Të përshkruajë standardet ndërkombëtare dhe rregullat e vizatimit teknik dhe të skicimit, etj.;
- Të përshkruajë shkrimin teknik dhe detalizojë vizatime përmbledhëse;
- Të përshkruajë simbolet kryesore që përdoren në teknologjinë kimike;
- Të përshkruajë skica dhe skema teknologjike të thjeshta dhe të vështirësive mesatare në proceset dhe shërbimet e teknologjisë kimike, etj.;
- Të përshkruajë standardet ndërkombëtare kryesore dhe kombëtare të prodhimeve të teknologjisë kimike;
- Të përshkruajë metodat kryesore për kryerjen e analizës cilësore dhe sasiore të lëndëve të para, lëndëve ndihmëse dhe prodhimeve të teknologjisë kimike;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjeve të recepturave për përgatitjen e lëndëve të para dhe ndihmëse në proceset dhe shërbimet e teknologjisë kimike, etj.;
- Të përshkruajë përdorimin e aparateve të matjes dhe kontrollit në proceset/shërbimet e teknologjisë kimike;
- Të përshkruajë mënyrën e formulimit të propozimeve dhe argumentimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e trajtimit dhe të ruajtjes së informacionit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit TIK;
- Të përshkruajë përdorimet dhe rëndësinë e Programin kompjuterik “AutoCAD”, “Visio” etj., për projektimin (vizatimin) e detaleve të thjeshta dhe skemave teknologjike;

Menaxhimi i materialeve dhe projektimi i proceseve teknologjike.

- Të përshkruajë markat/standartet kryesore të materialeve që përdoren në industrinë kimike, sidomos lëndët e para dhe ndihmëse (hidrokarburet, materialet e ndërtimit etj.), kimikatet, katalizatorët, aditivët, etj.;
- Të interpretojë, në mënyrë të përgjithshme, markat/standartet e materialeve, karakteristikat fizike e kimike, si dhe fushën e përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë në mënyrë të përgjithshme proceset teknologjike të përfundimit të produkteve të teknologjisë kimike, etj.;

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të këtij kualifikimi profesional në Nivelin IV të KSHK, referuar niveli IV të KEK individi duhet të jetë i aftë:

Sipërmarrja dhe menaxhimi i biznesit

- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar);
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti;
- Të analizojë të dhëna e treguesve tekniko-ekonomik për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë probleme në mënyrë krijuese;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të demonstrojë aftësi për të njohur dhe vlerësuar risqet;
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, bërë, kontrolluar dhe vepruar me qëllim për t'u vetë-përmirësuar;
- Të vlerësojë potencialin personal (aftësitë personale, sociale dhe për biznes, njohuritë e mëparshme, eksperiencën, etj.) për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të demonstrojë aftësi udhëheqëse në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të aplikuar parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të motivuar dhe inkurajuar të tjerët në arritjen e synimeve të tyre;
- Të aplikojë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burime e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to.
- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës.
- Të hartojë një plan efektiv biznesi në fushën e prodhimeve/shërbimeve “Teknologji kimike”, për krijimin e një biznesi të ri (ose për modifikim, shtesë, rinovimi, të një biznes ekzistues), për njësi të vogla prodhimi/shërbimi, për linja apo reparte prodhimi, duke u bazuar në procedura standarde;
- Të kryejë detyra tekniko-menaxheriale, në mbikëqyrje të inxhinierëve, për realizimin e një

plan biznesi, sipas planeve e programeve të hartuara nga menaxheret e nivelit me të lartë ose të një stafi menaxherial;

Normimi i punës, kostot dhe çmimet

- Të bëjë normimin e punës për produktet/shërbimet, duke pasur parasysh kohët kryesore të punimit/procesit teknologjik në makineritë dhe pajisjet e ndryshme, si dhe kohët e nevojshme në tërësinë të operacioneve ndihmëse (të përcaktuara në procesin teknologjik), deri në ambalazhimin e magazinimin e tyre;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta të kostos së prodhimit të një produkti/shërbimi teknologjik kimik të caktuar, duke marrë parasysh të gjithë elementet e saj, (kostot direkte dhe indirekte) ;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta të çmimit të produktit/shërbimit teknologjik kimik;
- Të bëjë menaxhimin e burimeve financiare dhe mbajtjen e plotësimin e dokumentacionit, sipas metodologjisë të përcaktuar për këtë qëllim;

Organizimi i punës

- Të organizojë në mënyrë ergonomike procesin e prodhimit/shërbimit, sipas posteve të punës dhe procesit teknologjik kimik të përcaktuar, deri në magazinimin dhe tregtimin e tyre;
- Të hartojë urdhrat të thjeshtë pune të punimeve dhe të përcaktojë volumet punës të posteve (linjës së prodhimit/shërbimit), ndarjen e detyrave sipas (grup) personave përgjegjës, duke përcaktuar hierarkinë, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, marrëdhëniet në organizimin e posteve të punës, mënyrën raportimit, afatet, etj.;
- Të zbatojë parimet e etikës në sjelljen ndaj punonjësve, vartësve dhe eprorëve;
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore duke kuptuar sjelljet e individit/grupit dhe duke aplikuar me efikasitet teknikat e motivimit, si uljen apo ngritjen në përgjegjësi, motivimin material e moral, etj.;
- Të përdorë mirë makineritë, pajisjet, armaturat linjat teknologjike dhe aparatet e matjes dhe kontrollit në njësinë prodhuese/shërbimit që menaxhon;
- Të përdorë të gjitha mjetet e pajisjet matëse të kontrollit sasior dhe cilësorë të produkteve të proceseve/shërbimeve të teknologjisë kimike të njësisë së prodhimit/shërbimit që menaxhon;
- Të kontrollojë cilësinë e proceseve të punës;

Menaxhimi i materialeve.

- Të hartojë plan-kërkesat për materialet kryesore dhe ndihmëse, duke u nisur nga nevojat e proceseve periodike dhe të vazhduara të prodhimit/shërbimit në teknologjinë kimike;
- Të kontrollojë e zbatojë standardet për analizat e treguesve cilësorë fiziko-kimike për, për furnizimet (blerjet) e materialeve dhe lëndëve të para e ndihmëse;
- Të krahasojë dhe të marrë vendim për çmimet dhe sasinë e blerjes së materialeve kryesore

dhe ndihmëse të nevojshme në proceset/shërbimit e teknologjisë kimike, si dhe për instrumentet dhe pajisjet përkatëse, duke pasur parasysh afatin e përdorimit, ciklin e punës dhe volumin e prodhimit, ... etj.

- Të marrë pjesë në hartimin e planit të rezervës së nevojshme të materialeve (stokut), për të garantuar vazhdimësinë dhe vijueshmërinë e prodhimit;

Standardet teknike/teknologjike, dhe projektimi procesit teknologjik

- Të lexojë shkrimin teknik dhe simbolet kryesore që përdoren në teknologjinë kimike;
- Të lexojë skicat dhe skemat teknologjike të thjeshta dhe të vështirësive mesatare të proceseve të teknologjisë kimike etj.;
- Të bëjë projektimin e detaleve të thjeshta, duke përfshirë vendosjen e simboleve, tolerancave, pastërtinë sipërfaqësore, kushtet teknike etj.;
- Të zbatojë standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të prodhimeve të teknologjisë kimike;
- Të përdorë metodat kryesore për kryerjen e analizës cilësore dhe sasiore të lëndëve të para, lëndëve ndihmëse dhe prodhimeve të teknologjisë kimike;
- Të përdorë mënyrat e llogaritjeve të recepturave për përgatitjen e lëndëve të para dhe ndihmëse në proceset dhe shërbimet e teknologjisë kimike, etj.;
- Të përdorë aparatet e matjes dhe kontrollit në proceset/shërbimet e teknologjisë kimike;
- Të përdorë programin AutoCAD, për projektimin e detaleve të thjeshta mekanike, duke përfshirë vendosjen e simboleve, tolerancave, pastërtinë sipërfaqësore, kushtet teknike etj.;
- Të përdorë programin kompjuterik “AutoCAD” dhe “Visio” etj., për projektimin (vizatimin) e detaleve të thjeshta dhe skemave teknologjike;

Mirëmbajta

- Të identifikojë defekte të thjeshta dhe parregullsitë në makineritë, pajisjet, aparaturat, armaturat (saracineska, ventila, fllanxha, valvula moskthimi dhe sigurimi), tubacionet, të impianteve në linjën apo njësinë e prodhimit/shërbimit të teknologjisë kimike, si dhe të konstruksioneve të ndryshme mekanike dhe teknologjike, etj.), në njësinë prodhuese që ai menaxhon, duke gjykuar për shkaqet e tyre dhe në konsultë me riparuesit/remontierët;
- Të bashkëpunojë në hartimin e planeve të remontit periodik dhe vjetor për makineritë, pajisjet, aparaturat, armaturat dhe tubacionet, të impianteve në linjën apo njësinë e prodhimit/shërbimit të teknologjisë kimike, duke parashikuar koston për kryerjen e remonteve;
- Të bashkëpunojë në hartimin e planeve të riparimit/remontit periodik dhe vjetor të sistemeve të furnizimit me energji, uji, të telekomunikacionit, të avullit të ujit, të ajrit, gazit inert, të shkarkimeve të ujërave teknologjik dhe të shërbimit, mbetjeve të ngurta dhe të gazrave industrial/shërbimit, duke parashikuar koston për kryerjen e riparimeve/remonteve etj.;

Informimi dhe komunikimi

- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit, për të bërë të mundur sigurimin e informacionit nga të gjitha burimet e mundshme, si interneti, shtypi, revistat, librat, reklamat, botimet e karakterit periodik teknik, etj.,

Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, duke përfshirë, përveç aspekteve teknike/teknologjike të sigurisë, plotësimin e dokumentacionit të detyrueshëm për instruktimin e punonjësve;
- Të mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë;
- Të zbatojë dokumentacionin e “vlerësimit të riskut” në teknologjinë kimike;
- Të afishojë, për çdo post pune, rregullat e sigurimit teknik, dhe të mbrojtjes ndaj zjarrit, gazit dhe pluhurave, si dhe radhën e veprimeve për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarit në punë;
- Të demonstrojë dhënien e ndihmës së shpejtë në raste aksidentesh dhe avarish që shoqërohen me zjarre, eksplozione dhe toksifikime në proceset dhe shërbimet e teknologjisë kimike;
- Të përdorë mjetet e mbrojtëse dhe shpëtimit në rast aksidenti në punë i shoqëruar me zjarre, eksplozione, shpërthime gazi, fluid i lëngët dhe pluhurash;
- Të zbatojë normat/standartet e higjienës vetjake dhe kolektive të vendit të punës dhe ambienteve të prodhimit/shërbimit/tregtimit në teknologjinë kimike;

Legjislacioni i punës dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të punës, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit.
- Të asistojë në hartimin e një kontrate pune individuale, duke përfshirë, përveç kushteve të përgjithshme edhe ato specifike për llojin e punës që do të kryejë punonjësi.
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë, përveç aspekteve teknike/teknologjike, plotësimin e dokumentacionit të detyrueshëm për raportimet periodike;
- Të zbatojë standartet, urdhrat e sugjerimet e organeve shtetërore për menaxhimin e mbetjeve në njësinë e vet të punës;
- Të kërkojë dhe të përdorë pajisjet e nevojshme për neutralizimin e efekteve të gazrave të dëmshëm, të pajisjeve të pastrimit të ujërave të ndotur dhe të mbetjeve të ngurta që janë jo miqësore me mjedisin;
- Të kryejë grumbullimin, ambalazhimin, transportimin dhe trajtimin e mbetjeve të proceseve dhe shërbimeve të teknologjisë kimike;
- Të kryejë rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar nga proceset e teknologjisë kimike;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe ti shpërndajë ato, në dobi të kolegeve e punonjësve në njësisë e tij prodhuese;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente. Të ndërmarrë apo hedhë vazhdimisht ide te reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij, të jetë i matur dhe i sjellshëm me eprorët, vartësit, partnerët, etj.;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë aftësitë e tij, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të jetë i hapur dhe të veprojë si një ndërlidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe njësive të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes dhe të tretëve jashtë saj, si furnitorët, klientët, partneret, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë prodhuese;
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.

